



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr.264/2024

Datë: 19 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 19 mars 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Znj. Merita Kurtishi - Gaka, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prizren, avancohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prizren nga data 1 prill 2024.
- II. Obligohet znj. Merita Kurtishi - Gaka që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
- III. Znj. Merita Kurtishi - Gaka ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 19 mars 2024 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 16 shkurt 2024, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj. Merita Kurtishi - Gaka;
- Kryeprokurorit të PTH Prizren;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.